



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës



Opština Priština – Municipality of Prishtina

## KONTRATA

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**N.T. "INFO COM"** (në vazhdim "Operatori Ekonomik") me adresë: Rr. e Çlirimit nr.2 - Mitrovicë, me nr. të biznesit: **70013174** dhe me nr. fiskal: **600026092**, i përfaqësuar nga Drejtori: Burim Haxha, ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

**Furnizim me aparat fotografik dhe aksesorë** me numër identifikues **616-19-2973-1-3-6**

**Neni 1**                   **Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me aparat fotografik dhe aksesorë** me numër identifikues **616-19-2973-1-3-6**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **24.06.2019** dhe përfundon me **30.06.2019**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **5** ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i **[dërgimit të furnizimeve]** do të jetë **KOMUNA E PRISHTINËS**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

**Neni 2**                   **Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

**Neni 3                  Çmimi**

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **8.490,00 €; [Tetëmijë e katërqind e nëntëdhjetë] Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bortx Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

**Neni 4                  Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debithet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkasat thelbësore.

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6                  Kualiteti**

6.1 Kualiteti i **[furnizimeve]** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7                  Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të **[furnizimeve]**.

**Neni 8                  Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë. Autoriteti Kontraktues, pa njofim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9                    Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

**Neni 10                    Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktajoj pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

**Neni 11                    Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruzion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12                    Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **[specifiko gjykatën kompetente]** në pajtim me ligjin e Kosovës.

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen **[Shqip]**<sup>2</sup> në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	<i>Dukagjin Sofiani</i>	Emri:	<i>Nevzhat MEKOLLI</i>
Pozita:	<i>Menzaxheri</i>	Pozita:	<i>Z. i LARTË I PROF.</i>
Nënshkrimi:	<i>Dukagjin Sofiani</i>	Nënshkrimi:	<i>Nevzhat MEKOLLI</i>
Data:	<i>24.06.2019</i>	Data:	<i>24.06.2019</i>
Vula:		Vula:	



Për Autoritetin Kontraktues



<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

### PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.1	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues		Menaxheri i Projektit caktohet me vendim të ZKA pas nënshkrimit të kontratës
Dëmet e likuiduara	8	Norma e dëmeve të likuiduara është <b>0.25% e Çmimit final të Kontratës</b> në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <b>10%</b> të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit		Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <b>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës</b> në vlerë prej: <b>846 € (Tetëqind e dyzet e gjashtë euro)</b> në validitet prej <b>50 ditë</b>
Kualiteti i Kontrollit	7	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësise së Defekteve është <b>[12 muaj]</b>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes		Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	13	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherëshëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

FURNIZIMI ME APARAT FOTOGRAFIK DHE AKCESORE				
Pjesa nr.	Pershkrimi i pozitës	Njësia	Sasia	Çmimi pa TVSH
	I. Aparat fotografik DSLR me se paku 30 megapixel me pajisjet përcjellëse:			
	TRE (3) Lenta per apparat fotografik DSLR			
1	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 16-35 mm f 2.8 (apo ekuivalent)</li> <li>• 24-70 mm f 2.8 (apo ekuivalent)</li> <li>• 70-200 mm f 2.8 (apo ekuivalent)</li> </ul> <p>Blic per apparat fotografik I (Një) Bateri per apparat fotografik DSLR</p>	COPË	1	7.194.92
				8,490.00
				8,490.00



<b>Identifikim i operatorit ekonomik (oe)</b>	
Emri i oe:	N.T INFO COM
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit	BURIM HAXHA
oce:	
Nënshkrimi:	
data:	10.06.2019
vula:	